



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1169/prot
2

Gramsh, më 30 /03 /2026

V E N D I M

Nr. 18 Datë 27.03.2026

P Ë R

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË NR. 36 , DATË 29.04.2024 "PËR MIRATIMIN E NJË SIPËRFAQE TRUALLI PREJ 540 M² (PESËQIND E DYZET) METRA KATËROR, PJESË E PASURISË 8/132, ZONË KADASTRALE 1842 E CILA ËSHTË NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, SI TRUALL PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT, QË DO TË NDËRTOHET NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE (EKB) ME KOSTO TË ULËT, PËR QËLLIME STREHIMI."

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës bazuar në Ligjin Nr. 139, datë 17/12/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 24, pika 2 dhe 54, gërma "e", Ligjin Nr. 107/2014, datë 01/10/2014 i ndryshuar "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"; VKM-në Nr.408, datë 13/05/2015, i ndryshuar "Për Miratim e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" me Propozimin të Kryetarit të Bashkisë Këshilli i Bashkisë .

V E N D O S I:

1. Të miratoj një sipërfaqe trualli prej 600 m² (gjashtëqind) metër katrorë me nr. pasurie 8/662, Zona Kadastrale 1842 e cila është në pronësi të Bashkisë Gramsh si truall për ndërtimin e objektit, që do të ndërtohet nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) me kosto të ulët, për qëllime strehimi sipas hartës dhe planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Sipërfaqja e truallit sipas pikes 1 (një) të këtij vendimi i jepet në pronësi Entit Kombëtar të Banesave (EKB) në funksion të ndërtimit të objektit me qëllim strehimin e banorëve të gjendur apo të deklaruar pa një strehim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

